



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.85/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave Uniteti sh.a. nga Mitrovica ndaj debitorit H.K. kafiteri rr.....-Vushtri për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.375/19, të datës 06.04.2020, jashtë seancës me datë 23.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit H.K. kafiteri rr.....-Vushtri, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.375/19 të datës 06.04.2020, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, me aktvendimin e atakuar, CPP.nr.375/19, të datës 06.04.2020, me pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit H.K. kafiteri rr.....-Vushtri, i ushtruar kundër urdhrit të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa nga Vushtria P.nr.1553/19 të datës 24.09.2019, ashtu që ka detyruar debitorin që në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të vendimit, t,ia paguaj kreditorit shumën prej 417.60€ në emër të borgjit të pa paguar, pr shërbime të heqjes së mbeturinave për periudhën kohore 31.08.2016 e deri me dt.31.08.2019. Në pikën II të dispozitivit, ka refuzuar pjesërisht propozimin për përmbartim i kreditorit, si të pabazuar në lartësi prej 1,519.07€.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale të LPP-së, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa dhe të ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.375/19 të datës 06.04.2020, të anulohet në tërsi urdhëri përmbartimor edhe sa i përket obligimit për borxhin prej 417.60€, ngase ky borxh bazuar në periudhën kohore është i vjetërsuar.

Gjyqtari individual i Dhomës së Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Regjionale e Mbeturinave Uniteti sh.a. nga Mitrovica, me datën 24.09.2019, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit H.K. kafiteri rr.....-Vushtri, në bazë të dokumentit autentik dhe faturave të dorëzuara debitorit, për borxhin në shumë prej 1,936.67 Euro me kamatë ligjore 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Përbaruesi Privat Atip Mustafa nga Vushtria, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin P.nr.1553/2019, të datës 24.09.2019, e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datën 30.09.2019, ka ushtruar prapësim duke theksuar se për vitet paraprake 2006,2005 si dhe prej vitit 2007 e tutje debitori nuk është faturuar dhe nuk janë kryer shërbimet nga ana e kreditorit. Borxhi është parashkruar për këtë periudhë kohore në bazë të nenit 360 par.1 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin e atakuar CPP.nr.375/19, të datës 06.04.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitivit të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se pjesa e borgjit të debitorit në lartësi prej 1,519.07€ është parashkruar për periudhën kohore 01.01.2013 deri 31.08.2016 ndërsa pjesa tjetër e borgjit prej 417.60€ për periudhën kohore 31.08.2016 deri 31.08.2019 nuk është parashkruar në pajtim me nenin 353 të LMD-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave të shërbimeve për heqjen e mbeturinave ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret

kemi të bëjmë me dokument të besueshëm-faturat në emër të shërbimeve të kryera, të cilat në rastin konkret sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë në bazë të nenit 353 të LMD-së është paraparë që kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra, qofshin ato kërkesa periodike aksesore apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, parashkruhen tri vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me shkeljet esenciale të LPP-së apo zbatimin e gabuar të së drejtës materiale respektivisht lidhur me atë se gjykata e shkallës së parë është dashur që edhe shumën prej 417.60€ ta konsideroi si borgj i parashkruar pasi që debitori nuk është faturuar asnjëherë dhe se nuk ka kryer ndonjë pagesë që nga vitit 2007. Duke marrë për bazë se borgji i faturave në shumë prej 417.60€ përfshin periudhën kohore 31.08.2016 deri 31.08.2019, kjo gjykatë konstaton se shuma e borxhit nuk ka arrit parashkrimin në bazë të nenit 353 të LMD-së,

Andaj në këtë drejtim Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon në tërësi si të bazuar qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa pretendimet ankimore të debitorit rezultojnë si të pathemelta.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.85/22

Gjyqtari
Krenar Berisha